

Paketa ligjore për shërbimet e kujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuara.



Leave
No One
Behind

Ky material është përgatitur nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDKPAK), në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara ‘Askush të Mos Mbetet Pas/Leave No One Behind’ (LNB), i cili zbatohet në bashkëpunim me Qeverinë Shqiptare dhe mbështetet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Përgatiti në gjuhë të thjeshtë për tu kuptuar: Flavia Shehu.



1.	Hyrje	02
2.	Fjalor	03 - 08
3.	Të drejtat dhe ligji	09 - 12
4.	Kuadri ligjor për shërbimet shoqërore	13 - 82
	4.1. Ligji Nr. 121, datë 21.11.2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në republikën e Shqipërisë”.	
	4.2. Vendim Nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”.	
	4.3. Vendim Nr. 722, datë 11.11.2019 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”.	
	4.4. Vendim Nr. 822, datë 6.12.2006 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuara, në qendrat rezidenciale dhe ditore”.	
	4.5. Udhëzim Nr. 597, datë 22.12.2017 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, asistencë shtëpiake për personat me aftësi të kufizuara”.	
	4.6. Vendim Nr. 111, datë 23.2.2018 “Për krijimin dhe funksionimin e fondit social”.	
5.	Plani Kombëtar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2021-2025.	83 - 100

1. Hyrje



Paketa ligjore do të shërbejë për të njohur më mirë ligjet për shërbimet e kujdesit shoqëror.

Dokumenti i shërben personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre.

Në këtë dokument ju do të gjeni edhe informacion për planet e ardhshme në lidhje me personat me aftësi të kufizuara.



Këtu do të gjeni informacion në lidhje me:

- Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.
- Ligjin për shërbimet e kujdesit shoqëror.
- Vendimet që lidhen me shërbimet.
- Standardet e kujdesit shoqëror.
- Planin kombëtar për personat me aftësi të kufizuara 2021-2025.

2. Fjalor

Abuzim do të thotë veprim ose shprehje që shkakton dëme te personi.

Aftësim profesional do të thotë mësimi i aftësive të reja për t'i përdorur në vendin e punës.

Aksesi është mundësia për të marrë informacione dhe shërbime.

Aksesueshmëri do të thotë heqja e pengesave të të gjitha llojeve për të marrë shërbime dhe informacion.

Ankimim do të thotë paraqitje e një pakënaqësie.

Arsim gjithëpërfshirës do të thotë mundësi për edukim për të gjithë fëmijët në të njëjtën klasë.

Bashkitë janë institucione publike të dedikuara për një qytet ose fshat të caktuar.

Buxhet i shtetit janë të ardhurat e shtetit.

Cilësia e jetës është standardi i shëndetit, rehatisë dhe kënaqësisë që përjeton një individ.

Dinjiteti është tërësia e vlerave të një njeriu.

Ekspert quhet ai person që ka njohuri të thelluara në një çështje.

Financim do të thotë mbulim i nevojave për të ardhura.

Fitimprurës do të thotë që sjell fitime.

Fondi social është një fond vetëm për shërbime shoqërore.

Fushata është një veprim i organizuar për të arritur një qëllim.

I përkohshëm do të thotë për një kohë të caktuar.

Institucione qendrore janë institucionet që janë për të gjithë vendin.

Intimiteti është ndjenjë ose mendim shumë personal i dikujt.

Jeta publike dhe politike është përfshirja e plotë në fusha të ndryshme të jetës.

Jofitimprurës do të thotë që nuk sjell fitime.

Këshilli bashkiak është një grupim individësh të cilët marrin vendime për një territor të caktuar.

Këshilli i Ministrave përbëhet nga të gjithë ministrat e vendit.

Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar është një grupim personash që mbrojnë të drejtat e PAK.

Komision do të thotë grupim i disa profesionistëve të fushave të caktuara.

Komisionim quhet kur PAK paraqitet për vlerësim në mënyrë që të përfitojë të ardhura ose shërbime.

Konventa për Personat me Aftësi të Kufizuara ka qëllim të sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë të drejtat e tyre.

Kriteret janë një grup kushtesh të cilat duhet të plotësohen.

Kuadër institucional do të thotë grupimi i institucioneve që lidhen me PAK.

Kuadër ligjor do të thotë grupimi i ligjeve që lidhen me PAK.

Kujdes shëndetësor është përpjekja për të ruajtur trupin dhe mendjen tonë nga sëmundjet.

Ligjet janë rregulla të shkruara të cilat duhet të zbatohen nga të gjithë.

Modeli biopsikosocial është një model që vlerëson personin në shumë fusha.

Monitorim do të thotë vëzhgim i thelluar.

Ndihmësi personal është një individ i zgjedhur nga PAK për ta ndihmuar të kapërcejë pengesat e përditshme.

Neglizhenca është mungesa e vëmendjes ndaj nevojave të dikujt.

Nenet janë pjesë të vogla që shërbejnë për të ndarë informacionin sipas kategorisë.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë institucione të cilat shërbejnë për një territor të caktuar.

Organe jopublike janë institucione private.

Organe publike janë institucionet shtetërore.

Paketë ligjore do të thotë grupim i ligjeve, vendimeve dhe udhëzimeve më të rëndësishme.

Përfaqësues ligjor quhet një person që merr përgjegjësitë e dikujt tjetër.

Përfitues është individi ose familja që përmbush kushtet për të përfituar nga shërbimi shoqëror.

Përfshirje shoqërore është të marrësh pjesë në fusha të ndryshme të jetës.

Person me aftësi të kufizuara është individi që ka një dëmtim:

- Fizik.
- Mendor.
- Intelektual.
- Shqisor.

Ky dëmtim në ndërveprim me barriera të ndryshme pengon pjesëmarrjen e individit në shoqëri.

Person me aftësi të kufizuara shkurt quhet PAK.

Plan individual do të thotë tërësi masash që duhet të merren vetëm për personin.

Plani Social është një plan i cili paraqet të gjitha nevojat e identifikuara në territorin e bashkisë.

Procedurat janë mënyra të veçanta të të vepruarit për të arritur diçka.

Profesionistët janë specialistë në një fushë të caktuar.

Punëdhënës quhet ai që ofron punën.

Punëmarrës quhet ai që e përfiton punën.

Punonjësi social i njësisë së qeverisjes vendore është profesionisti i cili do të ndjekë rastin.

Referim do të thotë drejtim për diku tjetër.

Reformë do të thotë ndryshim i thellë i diçkaje për ta përmirësuar atë.

Ristrukturim do të thotë ndryshim i brendshëm.

Shërbim i kujdesit shoqëror është një sistem përfitimesh dhe lehtësish.

Shërbime jopublike janë shërbime që ofrohen nga institucione private.

Shërbime publike janë shërbimet që ofrohen nga institucionet publike.

Shërbimet në nivel lokal janë shërbime që jepen nga bashkia.

Shërbimet në nivel qendror janë shërbime që jepen nga qeveria.

Shportë e shërbimeve quhet tërësia e shërbimeve.

Sinergji do të thotë kombinim dhe organizim i përbashkët.

Specialitetet janë fusha të ndryshme të ndërhyrjes.

Standardet janë një grup rregullash dhe kushtesh për të matur cilësinë e një shërbimi.

Strategji do të thotë përcaktimi i qëllimeve dhe veprimeve që duhet të ndërmerren në të ardhmen.

Strehim do të thotë sigurim i një vendi për të banuar.

Tarifa janë pagesat që mund të jepen për shërbime.

Të ardhurat janë paratë që duhen për të ofruar shërbimin.

Të drejtat e njeriut janë ato karakteristika që ne mund t'i gëzojmë kudo ku jemi.

Trajnimi është edukim i veçantë për një çështje.

Tregu i punës do të thotë mundësitë që ekzistojnë për t'u punësuar.

Udhëzimet tregojnë më mirë zbatimin e procedurave ligjore.

Vendimet shërbejnë për të shpjeguar më mirë ligjin.

Vendimmarrja e mbështetur është marrja e një vendimi nëpërmjet një personi tjetër i cili të informon dhe të ndihmon.

Vendimmarrja është procesi i marrjes së vendimit.

Vlerësim shumëdisiplinor është vlerësimi që kryhet nga shumë profesionistë të fushave të ndryshme.

3. Të drejtat dhe ligji.



Çfarë janë të drejtat?

Të drejtat e njeriut janë ato karakteristika që ne mund t'i gëzojmë kudo ku jemi.

Të drejtat e njeriut janë të shkruara në Konventën e të Drejtave të Njeriut.

Ka një Konventë edhe për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.



Çfarë është Konventa për Personat me Aftësi të Kufizuara?

Konventa për Personat me Aftësi të Kufizuara shkurt quhet **KDKAK**.

KDKAK ka qëllim të sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë të drejtat e tyre.



KDPAK përbëhet nga **nene**.

Nenet janë pjesë të vogla që shërbejnë për të ndarë informacionin sipas kategorisë.

Nenet emërtohen me numra.



Çfarë janë ligjet?

Ligjet janë rregulla të shkruara të cilat duhet të zbatohen nga të gjithë.

Të drejtat tona mbrohen nga ligji.


Ligjet janë sipas vendit ku jetojmë.



Ligjet shkruhen nga profesionistë.

Ligjet ndahen sipas fushave të ndryshme.

Ligjet emërtohen me numër, datë dhe emër.



Çfarë janë vendimet?

Pas miratimit të ligjeve shkruhen **vendimet**.

Vendimet shërbejnë për të shpjeguar më mirë ligjin.

Vendimet shërbejnë edhe për ta zbatuar më mirë ligjin.

Vendimet shkruhen për të treguar akoma më shumë rregulla dhe **procedura**.

Procedurat janë mënyra të veçanta të të vepruarit për të arritur diçka.

Vendimet emërtohen me numra dhe emra.



Vendimet shkruhen nga **Këshilli i Ministrave**.

Këshilli i Ministrave përbëhet nga të gjithë ministrat e vendit.



Çfarë janë udhëzimet?

Udhëzimet tregojnë më mirë zbatimin e procedurave ligjore.

Udhëzimet janë dokumenta ligjore.

Udhëzimet shkruhen për një çështje shumë specifike.

Udhëzimet shkruhen nga Ministri.



Kjo është një **paketë ligjore** për shërbimet për PAK në Shqipëri.

Paketë ligjore do të thotë grupim i ligjeve, vendimeve dhe udhëzimeve më të rëndësishme.

4. Kuadri ligjor për shërbimet shoqërore

4.1 Ligji Nr. 121, datë 21.11.2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në republikën e Shqipërisë”.



Ligji Nr. 121/2016 ka si qëllim përcaktimin e rregullave për shërbimet e kujdesit shoqëror.



Ky ligj do të ndihmojë në mirëqenien e individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes.

Ky ligj do të ndihmojë në **përfshirjen shoqërore** të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes.

Përfshirje shoqërore është të marrësh pjesë në fusha të ndryshme të jetës.



Ky ligj përcakton:

- Llojet e përfitimeve dhe lehtësive.
- Individët dhe grupet e individëve që plotësojnë kushtet për përfituar.
- Procedurat e përfitimit të të drejtave për shërbimet e kujdesit shoqëror.
- Rolin dhe përgjegjësitë e **organeve publike** dhe **jopublike**.

Organe publike janë institucionet e vendit.

Organe jopublike janë institucione private.



Shërbim i kujdesit shoqëror është një sistem përfitimesh dhe lehtësish.

Shërbimet ofrohen nga profesionistë të fushave përkatëse.



Shërbimet kanë për qëllim sigurimin e mirëqenies së individëve dhe të familjeve.

Shërbimet kanë për qëllim sigurimin e pavarësisë dhe përfshirjes shoqërore të individëve dhe të familjeve.



Nga shërbimet e kujdesit shoqëror mund të ketë shumë **përfitues**.

Përfitues është individi ose familja që plotëson kushtet për të përfituar nga shërbimi shoqëror.

Përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror janë edhe personat me aftësi të kufizuara.



Sipas ligjit, shërbimet e kujdesit shoqëror ndahen në:

- **Shërbime shoqërore publike.**
- **Shërbime shoqërore jopublike.**

Shërbime jopublike janë shërbime që ofrohen nga institucione private.


Kjo lloj ndarjeje është në bazë të mënyrës së **financimit**.

Financim do të thotë mbulim i nevojave për të ardhura.



Shërbimet shoqërore publike ofrohen në:

- Qendrat komunitare.
- Qendrat rezidenciale.
- Qendrat ditore.
- Në shtëpi.



Këto shërbime mbështeten nga shteti dhe **bashkitë**.

Bashkitë janë institucione publike të dedikuara për një qytet ose fshat të caktuar.



Shërbimet shoqërore jopublike ndahen në:


- Shërbime fitimprurëse.
- Shërbime jofitimprurëse.



Ligji përcakton disa lloje shërbimesh.

Llojet e shërbimeve të kujdesit shoqëror janë:

- Shërbimet parashoqërore.
- Shërbimet në qendrat komunitare.
- Shërbimet në qendrat rezidenciale.
- Shërbimet shoqërore në situatë emergjence.
- Shërbimet e kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror.
- Shërbimet e specializuara.
- Shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line.



Shërbimet e specializuara janë shërbimet e ofruara nga profesionistë të specialiteteve të ndryshme.

Shërbimet e specializuara ofrohen nga ministria përgjegjëse dhe nga **njësitë e qeverisjes në nivel qarku**.

Njësitë e qeverisjes në nivel qarku janë institucione të cilat shërbejnë për një territor të caktuar.



Shërbimet parashoqërore përbëhen nga:

- Informimi dhe këshillimi.
- Shërbimi në familje.
- Mbështetja psiko-sociale.
- Ndërhyrja e hershme.



Informimi dhe këshillimi janë shërbime që kanë për qëllim përmirësimin e situatës së individit.

Ky shërbim mund të informojë dhe të drejtojë për në shërbimet e kujdesit shoqëror.



Shërbimi në familje është shërbim ndaj individit që jepet në shtëpi.

Shërbimet në familje ofrohen në familje edhe për personat me aftësi të kufizuara.



Shërbimi në familje përfshin:

- Furnizimin dhe shpërndarjen e ushqimeve të gatshme në shtëpi.
- Furnizim të barnave apo furnizime të tjera.
- Mbajtjen e higjienës personale.
- Plotësimin e nevojave të tjera të përditshme.
- Mbështetjen psiko-sociale.



Mbështetja psiko-sociale ofrohet individualisht ose në grup.

Mbështetja psiko-sociale ka për qëllim të:

- Inkurajojë.
- Rehabilitojë.
- Zhvillojë aftësitë njohëse.
- Zhvillojë aftësitë funksionale.
- Zhvillojë aftësitë komunikuese.
- Zhvillojë aftësitë shoqërore.



Mbështetja psiko-sociale mund të jepet edhe si pjesë e shërbimeve të specializuara.



Ndërhyrja e hershme është një shërbim individual.

Ndërhyrja e hershme ofrohet për fëmijët deri në 8 vjeç.



Ky shërbim mund të ofrohet në:

- Familje.
- Qendra sociale.
- Institucionet e arsimit të detyrueshëm.



Ndërhyrja e hershme jep:

- Ndhmë profesionale dhe stimuluese për fëmijët.
- Këshillim për prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes.



Ndërhyrja e hershme përfshin edhe **referimin** e fëmijës sipas nevojës.

Referim do të thotë drejtim për diku tjetër.



Shërbimet komunitare ofrohen në qendra komunitare ose në mjedise të tjera.

Shërbimet komunitare ofrohen si shërbime të plota ditore.

Qëndrimi i plotë ditor zgjat nga 6 deri në 8 orë në ditë.



Shërbimet e plota ditore mund të përdoren 1 ose disa ditë në javë.

Shërbimet e plota ditore mund të përdoren edhe gjatë të gjitha ditëve të punës.



Shërbimet komunitare ofrohen edhe si shërbime gjysmëditore.

Qëndrimi gjysmëditor nuk mund të jetë më shumë se 6 orë në ditë.



Gjatë qëndrimit në qendrën komunitare ofrohet:

- Siguria fizike.
- Shërbime për higjienën personale.
- Kujdes shëndetësor.
- Edukim.
- Rehabilitim psiko-social.
- Kalim i kohës së lirë në komunitet.
- Fuqizim i individit ose familjes.
- Çdo shërbim tjetër i nevojshëm, sipas nevojave të përfituesit.



Shërbimet në qendrat e zhvillimit janë shërbime komunitare.

Këto shërbime kanë për qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së PAK.

Qendrat e zhvillimit shërbejnë për personat deri në 21 vjeç.



Shërbimet në qendrat e zhvillimit përfshijnë:

- Terapi intensive psikosociale.
- Shërbim psikomotor.
- Aftësim të parametrave fizikë.
- Shërbime ortofonie.
- Shërbime riaftësimi për punë.
- Terapi zhvillimi.



Në ligj janë vendosur edhe shërbime **strehimi**.

Strehim do të thotë sigurim i një vendi për të banuar.



Shërbimi në strehëza ofrohet në mënyrë të përkohshme.

Ky shërbim ofrohet edhe për personat me aftësi të kufizuara.



Shërbimi në strehëza përfshin:

- Shërbimin e specializuar.
- Strehimin.
- Sigurinë fizike.
- Ushqimin.
- Kujdesin shëndetësor.
- Rehabilitimin psiko-social.
- Terapinë fizike.
- Aktivitete profesionale.
- Kalimin e kohës në komunitet.
- Edukimin, në varësi të nevojave të përfituesit.



Ky shërbim mund të ofrohet gjatë të gjitha ditëve të javës.

Ky shërbim përfshin edhe referimin në një shërbim tjetër.



Strehimi i përkohshëm është një shërbim i ofruar ndaj individëve që ndodhen në rrethana të vështira dhe emergjente.

Ky shërbim zgjat deri në referimin e tyre të një shërbim tjetër shoqëror.

Strehimi i përkohshëm zgjat deri në 6 muaj, por mund të zgjatë deri në 1 vit.



Strehimi afatgjatë u sigurohet individëve që kanë nevojë për kujdes të vazhdueshëm.

Ky shërbim ofrohet kur kujdesi nuk u ofrohet dot në familje.

Ky shërbim ofrohet edhe për personat me aftësi të kufizuara.



Strehimi i organizuar është një shërbim i kujdesit shoqëror në nivel vendor.

Ky shërbim ofrohet për 24 orë në ditë në **qendrat rezidenciale**.



Shërbime në qendrat rezidenciale janë shërbime të kujdesit 24-orësh.

Shërbimet rezidenciale janë shërbime afatgjata.

Këto shërbime ofrohen kur shërbimi në shtëpi nuk është i mundur.



Vendosja e personave në qendra kujdesi shoqëror bëhet me pëlqimin e individit.

Vendosja e personave në qendra kujdesi shoqëror bëhet me pëlqimin e **përfaqësuesit të tij ligjor**.

Përfaqëses ligjor quhet një person që merr përgjegjësitë e dikujt tjetër.



Vendosja në shërbim bëhet pas vlerësimit të:

- Gjendjes shoqërore të individit.
- Gjendjes ekonomike të individit.
- Gjendjes mjekësore të individit.



Pranimi në sistemin e shërbimeve të kujdesit shoqëror fillon me kërkesë.

Këtë kërkesë mund ta bëjë:

- Individ.
- Përfaqësuesi i tij ligjor.
- Psikologu.
- **Punonjësi social i njësisë së qeverisjes vendore.**



Punonjësi social i njësisë së qeverisjes vendore është profesionisti i cili do të ndjekë rastin.



Kërkesa paraqitet te punonjësi social.

Ky punonjës ndodhet në strukturën e njësisë së qeverisjes vendore.

Këshilli bashkiak vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës.

Këshilli bashkiak është një grupim individësh të cilët marrin vendime për një territor të caktuar.



Vendim merret brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.

Nëse shërbimi nuk ofrohet nga ajo njësi e qeverisjes vendore, rasti referohet te një njësi tjetër.



Ligji tregon edhe për **fondin social**.

Fondi social është një fond vetëm për shërbime shoqërore.

4.2. Vendim Nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”.



Vendim Nr. 518 shpjegon për :

- Shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar.
 - Shërbimet e kujdesit shoqëror rezidencial.
-



Vendimi shpjegon edhe për:

- **Kriteret** dhe procedurat për përfitimin e shërbimeve.

Kriteret janë një grup kushtesh të cilat duhet të plotësohen.

- Masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit.
-



Vendimi nr. 518 tregon që shërbimet e kujdesit shoqëror ndahen në:

- Shërbime parashoqërore.
 - Shërbime në komunitet.
 - Shërbime rezidenciale afatgjata.
 - Shërbime të specializuara.
-



Shërbimet parashoqëro përbëhen nga:

- Informimi dhe këshillimi.
- Ndërhyrja e hershme.
- Këshillimi on-line.



Shërbimet në komunitet përbëhen nga:

- Shërbimi në familje.
- Shërbimi alternativ.
- Shërbimi multifunksional.



- Shërbimi ditor dhe gjysmëditor.
- Shërbimi i emergjencës 72-orëshe.
- Shërbimi i strehimit të mbrojtur për të pastrehët.



Shërbimet parashoqëro kuptohen si shërbime komunitare.



Shërbimet në familje janë ato që ofrohen në familje për PAK.

Këto shërbime u ofrohen vetëm atyre që e kanë të pamundur të marrin shërbime ditore komunitare apo rezidenciale.

Këto shërbime u ofrohen vetëm atyre që e kanë të pamundur të kujdesen për veten.

Këto shërbime u ofrohen vetëm atyre që nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari/ndihmësi personal.



Shërbimi në shtëpi përfshin:

- Shërbime rehabilitimi, zhvillimi, këshillim psikologjik dhe ligjor sipas rastit.
- Shpërndarjen e ushqimeve të gatshme në shtëpi.
- Dhënien e medikamenteve sipas recetës së mjekut apo shërbime të tjera të kujdesit të shëndetit.
- Mbajtjen e higjienës personale.



- Përbushjen e nevojave të tjera të përditshme sipas rastit.



Shërbimi multifunksional përfshin një shumëllojshmëri shërbimesh.

Këto shërbime janë të specializuara.

Këto shërbime u ofrohen të gjithë atyre që kanë nevojë.



Shërbimi multifunksional siguron:

Shërbime për rehabilitimin fizik dhe psikosocial.

- Këshillim ligjor falas.
- Këshillim për prindërimin dhe punësimin.



Shërbimi multifunksional siguron edhe:

- Këshillim për edukimin shëndetësor.
- Arsimim dhe argëtim.
- Fuqizimin e individit apo familjes.
- Çdo shërbim tjetër të nevojshëm të identifikuar.



Qendrat ditore ofrojnë shërbim gjysmëditor ose të plotë ditor.

Shërbimet në qendrat ditore mund të përdoren 1 ose disa ditë në javë.

Shërbimet në qendrat ditore sigurojnë shërbime të veçanta sipas përfituesve.

Shërbimet në qendrat ditore ofrohen edhe për personat me aftësi të kufizuara.



Shërbimet për PAK përfshijnë:

- Terapi zhvillimi.
- Fizioterapi.
- Logopedi.
- Ortofoni.
- Terapi okupacionale.
- Mbështetje psikologjike.
- Përkujdesje fizike.
- Ushqim për qëndrimin ditor.





Shërbimi i emergjencës 72-orëshe u ofrohet individëve që kanë nevojë për ndihmë të menjëhershme.

Ndihma e menjëhershme mund të vijë për shkak të një situatë që u kërcënon jetën dhe shëndetin.



Ky shërbim siguron menjëherë:

- Akomodim.
- Ushqim.
- Mjedis të mbrojtur.

Ky shërbim ngrihet edhe për fëmijë me aftësi të kufizuara.



Shërbimi për të pastrehët ofrohet për individë mbi 18 vjeç.

Ky shërbim ofrohet për ata që nuk kanë strehë banimi.

Ky shërbim ofrohet për ata që janë në vështirësi ekonomike.



Ky shërbim ofron:

- Strehim gjatë natës.
- Mensë.
- Mbështetje me këshillim dhe referim për fuqizim dhe riintegrim sa më të shpejtë.



Shërbimi i strehimit të mbrojtur u ofrohet edhe PAK, të cilët nuk kanë një strehë.

Ky shërbim ka formën e një banimi të veçantë ose në formën e banesave individuale.



Shërbime rezidenciale janë shërbimet që ofrohen në qendrat rezidenciale.

Këto shërbime përfshijnë shërbime të kujdesit 24-orësh dhe afatgjatë për individët.



Në shërbimet rezidenciale përfshihen:

- Shërbime në qendrat e zhvillimit.
- Strehimi afatgjatë.
- Shërbimi në strehëza.



Shërbimet në qendrat e zhvillimit janë për personat me aftësi të kufizuara.

Këto qendra sigurojnë përmirësimin e aftësive të personit.

Qendrat e zhvillimit shërbejnë për personat deri në 21 vjeç.



Shërbimet në qendrat e zhvillimit përfshijnë:

- Terapi intensive psikosociale.
- Shërbim psikomotor.
- Aftësim të parametrave fizikë.
- Shërbime ortofonie.
- Shërbime riaftësimi për punë.
- Terapi zhvillimi.



Strehimi afatgjatë ofrohet dhe për personat me aftësi të kufizuara.

Shërbimi në strehëza ofrohet në mënyrë të përkohshme.

Ky shërbim ofrohet edhe për personat me aftësi të kufizuara.



Shërbime të specializuara janë shërbimet specifike që i nevojiten personave.

Këto shërbime ofrohen në të gjithë vendin.

Shërbimet e specializuara përfshijnë shërbime zhvilluese dhe rehabilituese.

Këto shërbime ofrohen për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara.




Procedurat për përfitimin e shërbimeve komunitare e rezidenciale

Për të përfituar nga shërbimet komunitare rezidenciale duhen plotësuar disa kërkesa.



Procesi i përfitimit fillon me kërkesën e paraqitur nga:

- Individit apo familja.
- Punonjësi i njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit.
- Organizata joqeveritare.
- Ofrues të shërbimeve publike e jopublike.
- Punonjësi i policisë së shtetit.
- Punonjësi apo institucionet që janë në kontakt me individin apo familjen.
- Çdo person tjetër i interesuar.



Kërkesa për marrjen e shërbimit kryhet pranë punonjësit social në njësinë e qeverisjes vendore.

Ky punonjës drejton procesin e përgatitjes së dokumentacionit.

Punonjësi social i siguron dokumentet nëpërmjet kërkesave në institucione.



Së bashku me PAK kryhet vlerësimi i nevojave dhe i riskut.

Ky vlerësim realizohet në mjedisin e PAK.



Ky vlerësim përfshin edhe vlerësimin shumëdisiplinor.

Vlerësim shumëdisiplinor është vlerësimi që kryhet nga shumë profesionistë të fushave të ndryshme.



Punonjësi social informon dhe jep këshilla.




Këshillat jepen për:

- Të drejtat dhe mundësitë për kujdes dhe trajtim.
- Këshillim për shërbimet shëndetësore.
- Këshillim për shërbimet arsimore të mundshme.
- Informim bazë për pagesat sociale.



Punonjësi social brenda 10 ditësh kalon informacionin te **komisioni** shumëdisiplinar.

Komision do të thotë grupim i disa profesionistëve të fushave të caktuara.



Komisioni do të bëjë vlerësimin e plotë të rastit.

Komisioni shumëdisiplinar analizon kërkesën dhe dokumentacionin.



Komisioni pas marrjes së vendimit e çon pranë ofruesit të shërbimit.

Në rast se komisioni e refuzon e çon pranë njësisë që ka marrë iniciativën për dërgimin e individit në institucion.



Vendimi final për të ofruar shërbimin e kërkuar merret deri në 1 muaj nga data e kërkesës.

Vendimi merret nga këshilli i bashkisë nëse shërbimi është pjesë e bashkisë.



Vendimi merret edhe nga këshilli i qarkut.

Vendimi merret edhe nga drejtoria e **shërbimit social shtetëror**.

Shërbimi social shtetëror është një institucion publik.

Kjo ndodh në rast se nuk ka shërbim rezidencial në vendin ku jeton individi.



Pas marrjes së vendimit dokumentacioni dhe vendimi çohen pranë shërbimit specifik.

Në rast se kërkesa nuk është miratuar i rikthehet individit apo familjes.



Në shërbimin rezidencial, çdo 6 muaj rivlerësohen të gjitha kushtet e individit.

Kushtet që vlerësohen janë ato që kanë shkaktuar largimin nga familja apo shërbimi komunitar.

Në rast se verifikohet që nuk ka më arsye, ndiqen procedurat për largimin nga shërbimi rezidencial.




Kriteret e përfitimit të shërbimit dhe përmbajtja e dosjes.

Organet publike në nivel vendor sigurojnë planifikimin në planet sociale.

Këto organe sigurojnë realizimin e **shportës bazë të shërbimeve** shoqërore.

Shportë e shërbimeve quhet tërësia e shërbimeve.




Organet publike caktojnë kriteret e shërbimit.

Ata caktojnë edhe dokumentacionin e nevojshëm që duhet për tu kualifikuar.



Për të përfituar nga shërbimi i strehimit të mbrojtur duhet që individët:

- Të kenë një lloj aftësie të kufizuar sipas komisionit përgjegjës të vlerësimit të aftësisë së kufizuar.
- Të jenë të pastrehë dhe/ose familjarë të tyre nuk mund të kujdesen për ta.
- Të kenë zhvilluar aftësitë për jetesë të pavarur ose gjysmë të pavarur.




Për të filluar procesin duhet dorëzuar kërkesa.

Më pas punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore plotëson dosjen e individit me dokumente dhe të dhëna.



Për të përfituar nga shërbimet rezidenciale për PAK duhen plotësuar kriteret e mëposhtme:

- Të kenë një lloj aftësie të kufizuar sipas komisionit përgjegjës të vlerësimit të aftësisë së kufizuar.
- Moshë e përfituesve është nga 0-21 vjeç.
- Nevoja për terapi zhvillimi për PAK, të cilët nuk mund t'i përfitojnë përmes shërbimeve komunitare.



Për të filluar procesin duhet dorëzuar kërkesa.

Më pas punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore plotëson dosjen e individit me dokumente dhe të dhëna.



Për të përfituar nga strehimi afatgjatë për PAK duhet të plotësohen kriteret e mëposhtme:

- Të jenë persona me aftësi të kufizuara.
- Për këta persona është e pamundur të sigurohet kujdesi në familje.



Për të filluar procesin duhet dorëzuar kërkesa.

Më pas punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore plotëson dosjen e individit me dokumente dhe të dhëna.




Shërbimet zhvilluese dhe rehabilituese përfitohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Personi duhet të jetë vlerësuar nga komisioni i vlerësimit të aftësisë së kufizuar.



Për të përfituar duhet që mjeku specialist të referojë për shërbime rehabilituese.

Mjeku duhet të specifikojë qartë shërbimin e nevojshëm.



Për të filluar procesin duhet dorëzuar kërkesa.

Më pas punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore plotëson dosjen e individit me dokumente dhe të dhëna.

4.3. Vendim Nr. 722, datë 11.11.2019 “**Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre**”.



Reforma e re e vlerësimit të aftësisë së kufizuar ka prezantuar **modelin biopsikosocial** të vlerësimit.

Reformë do të thotë ndryshim i thellë i diçkaje për ta përmirësuar atë.

Modeli biopsikosocial është një model që vlerëson personin në shumë fusha.



Në vlerësimin biopsikosocial do të përfshihen individët, që:

- Kërkojnë të vlerësohen për herë të parë.
- Kërkojnë të rivlerësohen.



Për marrjen e përfitimeve të aftësisë së kufizuar duhet të plotësohen kriteret, si më poshtë:

- Personi duhet të ketë një gjendje mjekësore të vërtetuar të një dëmtimi.

Ky dëmtim mund të jetë fizik, mendor, intelektual, shqisor.

- Duhet të vërtetohen kufizime të lehta, mesatare, të rënda ose të thella, të shkaktuara nga dëmtimi.
- Duhet të vërtetohen kufizime për të kryer veprimtari domethënëse të jetesës së përditshme.



Këto kufizime duhet të jenë të përshtatshme për moshën e personit.

Kufizimet nuk e lejojnë personin të marrë pjesë në jetën shoqërore, ekonomike e politike.




Për marrjen e përfitimeve të aftësisë së kufizuar duhet të plotësohen edhe kriteret, si më poshtë:

- Personi duhet të përjetojë kufizime mjedisore dhe të qëndrimit.



Këto kufizime ndikojnë në aftësinë për të kryer veprimtari të jetesës së përditshme dhe pjesëmarrje të barabartë në shoqëri.

- Personi duhet të jetë i paaftë për punë dhe të mos plotësojë kushtet ligjore për përfitim të pensionit të invaliditetit të punës.
- Personit duhet të mos i ketë lindur e drejta për përfitim të pensionit të pleqërisë apo social.



Për të qenë përfitues i aftësisë së kufizuar duhen plotësuar disa dokumenta.



Dokumentat janë:


- Formulari i aplikimit.
- Formulari i plotësuar nga mjeku i familjes.
- Formulari i plotësuar nga mjeku specialist i qendrave



shëndetësore të specialiteteve apo të spitaleve.

Në rast se nuk mbulohet nga qendrat shëndetësore plotësohet nga spitalet.

- Për fëmijët, formulari mund të plotësohet edhe nga Qendra Kombëtare e Mirërritjes, Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve (QKMZHRF).
- Kopjen e letërnjoftimit apo certifikatës personale me fotografi.



Dokumentet dorëzohen pranë zyrës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar.



Vlerësimi biopsikosocial i aftësisë së kufizuar bëhet sipas Klasifikimit Ndërkombëtar mbi Funkionimin, Aftësinë e Kufizuar dhe Shëndetin të Organizatës Botërore të Shëndetësisë.



Ky vlerësim përfshin:

- Faktorët që dëmtojnë aftësinë e një individi për të kryer veprimtari të jetesës së përditshme.
- Faktorët që dëmtojnë aftësinë e një individi për të marrë pjesë në shoqëri në kushte të barabarta me të tjerët.



Procesi i vlerësimit përfshin:

- Vlerësimin mjekësor të aplikuesit nga mjeku i familjes.
- Vlerësimin mjekësor të aplikuesit nga mjeku specialist.
- Një intervistë me aplikuesin nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë të kufizuar me mjekë dhe punonjës socialë.
- Verifikimin e informacionit të marrë.
- Kontrollin vjetor mjekësor.



Administrimi i procesit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar realizohet nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror.

Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror shkurt quhet DRSHSSH.

Pranë DRSHSSH krijohen komisionet shumëdisiplinore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar.



Këto komisione funksionojnë në çdo rajon.

Komisionet përbëhen të paktën nga një mjek dhe një punonjës social.



Anëtarët e komisionit janë të trajnuar për modelin biopsikosocial të vlerësimit të PAK.

Çdo komision mbështetet nga një punonjës, i cili administron dhe regjistron të dhënat e aplikuesit.



Komisionet kryesohen nga përgjegjësi i zyrës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar.



Stafi i zyrës së vlerësimit kryen këto detyra:

- Hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar të dhënat e aplikuesit.
- Vlerëson dhe analizon dosjet e paraqitura për vlerësim dhe rivlerësim.
- Verifikon dhe shkëmben informacionin elektronik me rrjetin e institucioneve të tjera.
- Cakton datën e intervistës dhe njofton zyrtarisht kërkuesit.
- Këtë e realizon nëpërmjet administratorit shoqëror.
- Në rast se ka mungesë dokumentacioni e kthen zyrtarisht dosjen për plotësim në njësinë administrative.
- Organizon kryerjen e intervistës brenda 30 ditëve nga data e marrjes së dokumenteve të aplikimit.
- Bën vlerësimin për përcaktimin e nevojës për ndihmës personal.



- Përcakton nivelin e përgjithshëm të aftësisë së kufizuar.
- Bën përgatitjen e rekomandimeve për shërbime të tjera
- Merr vendimin për përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar.
- Lëshon dokumentin që vërteton aftësinë e kufizuar.
- Shqyrton të dhënat e kontrolleve periodike të nevojshme.
- Mban, ruan dhe përditëson të dhënat e dokumentacionit të kërkuesve e të përfituesve të aftësisë së kufizuar.
- Adreson fëmijët e moshës shkollore pranë institucioneve arsimore vendore për vlerësimin e nevojave të tyre arsimore.



Drejtori i DRSHSSH nxjerr vendimin përfundimtar për të gjithë përfituesit e aftësisë së kufizuar.


Ai njofton zyrtarisht aplikuesin për vendimmarrjen.

Ai e pajis me dokumentin përkatës, që përcakton aftësinë e kufizuar.



Vendimi për përfitimet e aftësisë së kufizuar dhe të ndihmësit personal i çohet bashkisë për:

- Zbatimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të lëna nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit.
- Kryerjen e veprimeve financiare për dhënien e pagesës për përfituesit e aftësisë së kufizuar.



Administratori shoqëror pranë organeve të pushtetit vendor, ka përgjegjësi për:

- Hartimin e një plani individual të përvitshëm të shërbimeve, mbështetur në rekomandimet e



komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit.

- Kryerjen e vizitave në mjedisin ku jeton individi, jo më pak se 1 herë në 3 muaj.
- Informimin e zyrës së vlerësimit për ndryshimin e gjendjes së PAK.
- Informimin e individëve për shërbimet shoqërore ekzistuese në territorin e së cilës është banor individi.
- Informimin e individëve për kriteret, procedurat dhe dokumentacionin që duhet të plotësojnë për vlerësim dhe rivlerësim të aftësisë së kufizuar.
- Informimin e familjarëve për të drejtat e PAK për t'u përfshirë në të gjitha aspektet e jetës shoqërore.
- Informimin e familjarëve për të drejtën e fëmijëve me aftësi të kufizuara për t'u arsimuar.
- Monitorimin dhe mbështetjen e shërbimit të asistencës personale.



- Evidentimin, raportimin dhe referimin e rasteve të **abuzimit** e të **neglizhencës**.

Abuzim do të thotë veprim ose shprehje që shkakton dëme te personi.

Neglizhenca është mungesa e vëmendjes ndaj nevojave të dikujt.



Administratori shoqëror pranë organeve të pushtetit vendor, ka përgjegjësi edhe për:


- Evidentimin dhe verifikimin e rasteve të personave që përfitojnë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.
- Ndërprerjen e pagesës së aftësisë së kufizuar për personat që qëndrojnë jashtë vendit për më shumë se 3 muaj.
- Informimin dhe udhëzimin në komunitetet lidhur me skemën e aftësisë së kufizuar, me anë të **fushatave** të ndryshme informuese.



Fushata është një veprim i organizuar për të arritur një qëllim.



- Bashkëpunimin me punonjësit socialë, që janë pjesë e strukturave të ndryshme.
- Adresimin e rasteve të PAK drejt programeve të tjera sociale, shëndetësore, të arsimit e formimit profesional dhe të punësimit, me qëllim rehabilitimin dhe integrimin e tyre në jetën shoqërore, në përputhje edhe me rekomandimet e komisionit.



Përfitimet në pagesa dhe shërbime.

Pagesa për shkak të aftësisë së kufizuar është një pagesë mujore.

Kjo pagesë jepet në muajin pasardhës.



Ata të cilët vlerësohen se kanë nevojë për paketë higjieno-sanitare, përfitojnë një pagesë shtesë në të ardhura për mbulimin e shpenzimeve të paketës.

Niveli i aftësisë së kufizuar dhe



përfitimet përcaktohen bazuar në vlerësimin biopsikosocial.

Pagesat për PAK kryhen nëpërmjet bankës ose postës.



PAK, që ndjekin një kurs kualifikimi dhe nxënësit, të cilët ndjekin arsimin e mesëm të lartë, përfitojnë pagesë në masën 200% të pagesës si PAK.

Kjo përfitohet vetëm gjatë kohës që ndjekin kursin apo shkollën brenda afatit të përcaktuar për ta kryer.



Studentët, të cilët ndjekin arsimin e lartë, përfitojnë pagesë në masën 300% të pagesës si PAK.

Kjo përfitohet vetëm gjatë kohës që ndjekin studimet brenda afatit të përcaktuar për kryerjen e tij.



Për personat që ndjekin studimet e doktoratës dhe për personat që ndjekin procedurat për fitimin e një titulli akademik, kjo pagesë përfitohet në mënyrë të përhershme.



PAK me kufizime të rënda apo të thella gëzojnë të drejtën e përfitimit të **ndihmësit personal**.

Ndihmësi personal është një individ i zgjedhur nga PAK për ta ndihmuar të kapërcejë pengesat e përditshme.



Shkalla e nevojës për shërbimet e ndihmësit personal përcaktohet në bazë të vlerësimit të kryer nga komisioni shumëdisiplinor.


Pagesat për shërbime të ndihmësit personal jepen në muajin pasardhës.

Pagesa kryhet nëpërmjet bankës ose postës.



Procedura e ankimimit

Aplikuesi ka të drejtën e ankimimit për procedurën e vlerësimit në rastet e refuzimit të aplikimit për përfitime për shkak të aftësisë së kufizuar.




Ankimimi bëhet me shkrim, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së njoftimit të vendimit.

Ankimimi bëhet pranë komisionit të shqyrtimit të ankesave në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.



Në rastet kur kërkesa pranohet, personit i lind e drejta e marrjes së përfitimeve që nga muaji pasardhës.

PAK, që pretendon se i është shkelur dhe/ose mohuar një e drejtë, gëzon të drejtën për të ngritur padi në gjykatë.



Nuk u nënshtrohen procedurës së vlerësimit:

- Të verbrit përfitues ose aplikues, që kërkojnë të përfitojnë sipas legjislacionit në fuqi për statusin e të verbrit.
- Paraplegjikët dhe tetraplegjikët që kërkojnë të përfitojnë sipas legjislacionit në fuqi për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik.

4.4. Vendim Nr. 822, datë 6.12.2006 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuara, në qendrat rezidenciale dhe ditore”.



Standardet e shërbimeve të kujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuara janë miratuar Këshilli i Ministrave në vitin 2006.

Standardet janë një grup rregullash dhe kushtesh për të matur cilësinë e një shërbimi.



Hartimi i standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror është një hap i rëndësishëm për rritjen e cilësisë së shërbimeve.

Standardet e shërbimeve synojnë respektimin e parimeve të dokumenteve themelore për të drejtat e PAK.



Vendosja e standardeve të shërbimeve do të garantojë dhe zhvillojë:

- Ushtrimin e të drejtave dhe lirive të PAK.
- Matjen dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.



- Përmbyshjen e funksioneve të reja të decentralizimit për njësitë e qeverisjes vendore.
- Barazinë e mundësive dhe akses të barabartë në shërbimet sociale.



Standardet janë hartuar nga një grup ekspertësh.

Gjithashtu ato janë diskutuar edhe me palë të interesit.



Standardet zërthejnë rregullat që duhet të zbatohen në shërbimet rezidenciale dhe ditore.

Standardet zërthejnë kriteret që duhet të plotësohen në shërbimet rezidenciale dhe ditore.

Standardet zërthejnë rezultatet që duhet të arrihen në shërbimet rezidenciale dhe ditore.



Nëpërmjet standardeve do të sigurohet dhe matet cilësia e shërbimeve.



Ky dokument, do të shërbejë për të ndihmuar vetë përfituesit për të kuptuar dhe kërkuar zbatimin e standardeve nga ofruesit e shërbimeve.

Ky dokument, do të shërbejë për të ndihmuar dhe familjarët e PAK për të kuptuar dhe kërkuar zbatimin e standardeve nga ofruesit e shërbimeve.



Standardet do të shërbejnë edhe si udhëzues praktik për ofruesit e shërbimeve.

Ofruesit e shërbimeve do të organizojnë dhe përmirësojnë shërbimet.

Standardet do të orientojnë profesionistët të cilët do të punojnë për këto shërbime.

Standardet vendosin rregulla dhe kritere për cilësinë e shërbimeve.



Standardet e ofrimit të shërbimit në qendra rezidenciale dhe ditore:

1. Pjesëmarrja në vendimarrje lokale.
2. Vlerësimi dhe plani individual i shërbimit.
3. Pavarësia, përfshirja dhe vetëvendosja.
4. Procedurat e shërbimeve.
5. Trajtimi i barabartë dhe ankimimi.



Më poshtë do të shpjegohen shkurtimisht standardet:

1. Pjesëmarrja në vendimarrje lokale.

Strukturat lokale duhet të bashkëpunojnë me:

- PAK.
- Familjarët e tyre.
- Organizatat përfaqësuese.



Ky bashkëpunim është për të parandaluar e shmangur diskriminimin dhe përjashtimin social të PAK.



2. Vlerësimi dhe plani individual i shërbimit.

Ky standard thekson vlerësimin e PAK nga një ekip shumëdisiplinar.

Ky ekip ngrihet nga organizata që merr përsipër dhënien e shërbimeve.

Çdo shërbim duhet të ketë procedura të qarta referimi.



Çdo shërbim duhet të ketë procedura të qarta vlerësimi.

Procesi i vlerësimit përfshin:

- Klientin.
- Të afërm të tyre ose përfaqësues të zgjedhur.
- Profesionistët sipas nevojave të klientit.
- Përfaqësues të organizatës që jep shërbimin.



Klienti ka të drejta të plota në vlerësimin përfundimtar.

Klienti ka të drejta të plota dhe në dokumenta të tjera në lidhje me të.



Përfaqësuesi i klientit ka të drejta të plota në vlerësimin përfundimtar.

Përfaqësuesi i klientit ka të drejta të plota dhe në dokumenta të tjera në lidhje me klientin.



3. Pavarësia, përfshirja dhe vetëvendosja.

Ky standard siguron që shërbimet mbulojnë nevojat funksionale jetike sipas:

- Nevojave të moshës së përfituesve.
- Nevojave fizike të përfituesve.
- Nevojave psikologjike të përfituesve.
- Nevojave sociale të përfituesve.



Duhet siguruar që shërbimet janë të një cilësie të mirë.

Shërbimet duhet të ofrohen në kohën e duhur.

Kjo shërben për mbështetje për një jetë sa më të pavarur në shoqëri.



4. Procedurat e shërbimeve.

PAK marrin shërbime profesionale.


Shërbimet ndjekin procedura të rregullta të:

- Referimit.
- Vlerësimet.
- Planifikimit.
- Ofrimit të shërbimit.



Shërbimet shumëdisiplinare realizohen nëpërmjet bashkëpunimit me organizata dhe institucione të ndryshme.

Përfituesit dhe përfaqësuesit e tyre janë tërësisht të përfshirë në këto procedura.



Organizata që ofron shërbime për PAK ka procedura të qarta për çdo hap të shërbimeve të ofruara.

Organizata që ofron shërbime për PAK ka procedura të rregullta për çdo hap të shërbimeve të ofruara.



Këto procedura janë të dokumentuara dhe të njohura si nga personeli dhe klientët.

Procedurat bazohen në punën me ekipe shumëdisiplinare.

Ato parashikojnë bashkëpunimin me organizata të tjera.

Procedurat përshkruajnë rolin e klientit ose përfaqësuesit të tij ligjor.



Roli i tyre përshkruhet në procesin e:

- Referimit.
- Vlerësimit.
- Planifikimit.
- Dhënies së shërbimit.
- Monitorimit.



5. Trajtimi i barabartë dhe ankimimi.

Ky standard ngre detyrimin për të hartuar kritere të qarta.

Kriteret e qarta janë për:

- Të drejtën e përfitimit të shërbimeve.
- Procedurat e monitorimit të zbatimit të këtij shërbimi.



Gjithashtu, klienti ose përfaqësuesi i tij kanë të drejtën e ankimimit.

Ankesat e tyre analizohen.

Ankesat shoqërohen me marrje masash për përmirësimin e gjendjes.

4.5. Udhëzim Nr. 597, datë 22.12.2017 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, asistencë shtëpiake për personat me aftësi të kufizuara”.



Hartimi i këtij dokumenti është i rëndësishëm në rritjen e kujdesit shtëpiak për PAK.

Standardet do të shërbejnë si një njësi matëse bazë.



Nëpërmjet tyre do të sigurohet dhe matet cilësia e shërbimeve.

Po ashtu, do të garantohet edhe ushtrimi i të drejtave për PAK.



Këto standarde vijnë në përputhje me ligjet dhe vendimet e këshillit të ministrave për shërbimet shoqërore.

Këto standarde janë në përputhje edhe me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.



Standardet vijnë për t'iu përgjigjur nevojave të PAK në ambientin e tyre në kohë dhe me cilësi.

Standardet do të rrisin pjesëmarrjen dhe gjithëpërfshirjen e PAK në komunitet.



Shërbimi i asistencës shtëpiake ka për qëllim sigurimin e mirëqenies sociale.

Ky dokument, do të shërbejë për të ndihmuar vetë përfituesit dhe familjarët e tyre për të kuptuar dhe kërkuar zbatimin e standardeve nga ofruesit e shërbimeve.



Standardet organizohen në 10 pika:

1- Informimi dhe vizita paraprake

PAK dhe familjarët vendosin mbi shërbimet që do të marrin.

Ata vendosin pasi kanë marrë informacion dhe janë siguruar që ky shërbim plotëson nevojat dhe kërkesat e tyre.



2- Vlerësimi paraprak i nevojave të klientëve dhe hartimi i një plani individual për kujdesi.

Plan individual do të thotë tërësi masash që duhet të merren vetëm për personin.

Ky standard siguron që PAK që banojnë në banesë tu sigurohet shërbimi i nevojshëm për ta.



3- Kujdesi shëndetësor dhe mjekimi sipas planit individual të përfituesit

Sigurohet që të nxitet dhe të ruhet shëndeti i përfituesve.

Kjo bëhet sipas një plani individual.

Ai plan merr parasysh kryerjen e analizave të nevojshme, ndjekjen e këshillave të mjekut dhe trajtimin me barna.



4- Respektimi i intimitetit dhe dinjitetit

PAK u sigurohet intimiteti dhe dinjiteti përfshirë për higjienën personale.

Kjo bëhet duke u ofruar ngrohtësi, durim dhe respekt.



5- Jeta sociale në shtëpi dhe lidhjet me komunitetin.

Ritmi i jetës dhe aktiviteteve të përditshme ndryshon vazhdimisht.

Ai u përshtatet dëshirave, kërkesave dhe mundësive të përfituesve.

PAK kanë të drejtë të presin vizitorë dhe të marrin pjesë në aktivitete familjare dhe aktivitete në komunitet.



6- Aktivitete integruese dhe plotësuese të kujdesit në shtëpi.

PAK u sigurohet ushqimi në shtëpi nëse është e nevojshme.

Mund të ofrohet edhe ndihma



për përgatitjen e ushqimeve dhe lëngjeve.

Ushqimet dhe lëngjet duhet të jenë të shëndetshme, të sigurta, cilësore dhe të shumëllojshme.

Ushqimet dhe lëngjet duhet të jenë dhe në sasi të mjaftueshme për gjendjen shëndetësore si dhe që plotësojnë dëshirat e personit.



7- Mbrojtja e të drejtave të klientëve, shmangia e abuzimit dhe procesi i ankimimit.

Klientët gëzojnë të gjitha të drejtat ligjore.

Ata mbrohen nga llojet e ndryshme të abuzimit.



Ankesat e personave analizohen.

Ankesat e personave shoqërohen me veprime konkrete për përmirësimin e gjendjes së tyre.



8 - Personel i kualifikuar për kryerjen e shërbimeve.

Klientët marrin shërbimet e nevojshme nga personel i kualifikuar.

Shërbimi i kujdesit shoqëror dhe shëndetësor duhet të këtë standarde të unifikuara në të gjithë vendin.



9- Shërbimet e asistencës shtëpiakë sociale dhe shëndetësore në ambientin natyral familjar ofrohen nga figura profesionale dhe Njësia Vlerësimit dhe Referimit të Rastit në Bashki/ Struktura tëposaçme apo një subjekt i licensuar.

PAK marrin shërbime profesionale që ndjekin procedura të rregullta.



Procedurat e rregullta janë:

- Referimi.
- Vlerësimi.
- Planifikimi.
- Dhënia e shërbimeve.



Procedurat respektojnë parimin e **vendimmarrjes së mbështetur** të përfituesit apo të përfaqësuesit të tij ligjor.

Vendimmarrja është procesi i marrjes së vendimit.

Vendimmarrja e mbështetur është marrja e një vendimi nëpërmjet një personi tjetër i cili të informon dhe të ndihmon.



10-Njësia e qeverisjes vendore siguron partneritet me të gjitha grupet e interesit për PAK mbi pazën e parimeve të gjithëpërfshirjes.

Njësitë administrative punojnë bashkë me PAK, familjarët e tyre si dhe organizatat e përfaqësuese të PAK.

Të gjithë bashkë kanë për qëllim të përmirësojnë cilësinë e jetës.

Të gjithë bashkë kanë për qëllim edhe parandalimin dhe shmangien e përjashtimit social.

4.6. Vendim Nr. 111, datë 23.2.2018 “Për krijimin dhe funksionimin e fondit social”.



Fondi social është një fond vetëm për shërbime shoqërore.

Nëpërmjet fondit social do të sigurohet mbështetje financiare për njësitë e qeverisjes vendore.



Fondi social krijohet nga bashkia në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse.

Fondi social administrohet nga bashkia në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse.

Fondi do të sigurojë mbështetje financiare për njësitë e qeverisjes vendore.




Qëllimi i fondit social është:

- Përmirësimi i standardeve të shërbimeve aktuale.
 - Krijimi i shërbimeve të reja.
 - Zhvillimi i politikave sociale.
-



Fondi social përbëhet nga:

- Fondet e kushtëzuara që akordohen nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale.
- Fondet nga buxhetet e njësive të vetëqeverisjes vendore, të parashikuara për shërbimet shoqërore dhe nga pasuritë që zotëron bashkia.
- Të ardhurat nga organizatat jofitimprurëse, individët e bizneset, si dhe donatorë të huaj e lokalë.
- Të ardhurat nga zbatimi i **tarifave** për shërbime të ndryshme të kujdesit shoqëror.



Tarifa janë pagesat që mund të jepen për shërbime.

- Tarifat për shërbimet për përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Nëse buxheti nuk shpenzohet, ai do të kalojë për vitin tjetër.



Njësia e vetëqeverisjes vendore vlerëson nevojat për shërbime të kujdesit shoqëror në nivel vendor.

Njësia e vetëqeverisjes vendore vlerëson mundësitë financiare që mbështesin ofrimin e shërbimeve në nivel vendor.

Njësia e vetëqeverisjes vendore vlerëson dhe burimet njerëzore që mbështesin ofrimin e shërbimeve në nivel vendor.



Ministria përgjegjëse për çështjet sociale parashikon në buxhetin e saj fonde për financimin e shërbimeve shoqërore.



Të gjitha shërbimet shoqërore që nuk mund të ofrohen prej bashkisë, mund të ofrohen nga organizata jofitimprurëse.

Ofruesit privatë ofrojnë shërbimet e kujdesit shoqëror si pjesë e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet palëve.

Bashkitë duhet të hartojnë **Planin Social**.



Planin Social është një plan i cili paraqet të gjitha nevojat e identifikuara në territorin e bashkisë.

Fondi social mbështet shërbimet që janë të parashikuara në Planin Social.

Në planin social bashkitë duhet të shkruajnë edhe nevojat për shërbime për PAK.



Njësia e vetëqeverisjes vendore raporton, çdo katër muaj, në lidhje me ofrimin e shërbimeve financiar me anë të fondit social, pranë Shërbimit Social Shtetëror.

5. Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025



Plani kombëtar për personat me aftësi të kufizuara shkurt quhet **PKPAK**.

PKPAK është një dokument i qeverisë shqiptare.

Ky dokument përfshin politika për PAK.

PKPAK është për 5 vitet e ardhshme.



Qëllimi i PKPAK është të mbështesë PAK për t'u përfshirë në jetën e vendit.

PKPAK është hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.



Kjo ministri ka ngritur një grup pune enkas për PKPAK.

Po ashtu, PKPAK është konsultuar edhe me **ekspertë**.

Ekspert quhet ai person që ka njohuri të thelluara në një çështje.



PKPAK mbështetet te Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

PKPAK është mbështetur edhe në rekomandimet e Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në **OKB**.

OKB është Organizata e Kombeve të Bashkuara.



Për të zbatuar PKPAK shteti duhet të financojë nga buxheti i tij.

Në rast se buxheti nuk është i mjaftueshëm mendohet të kërkohen fonde.



Zbatimi i PKPAK do të vëzhgohet nga **Këshilli Kombëtar i Aftësisë së Kufizuar**.

Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar është një grupim personash që mbrojnë të drejtat e PAK.

Këshilli Kombëtar i Aftësisë së Kufizuar shkurt quhet **KKAK**.

PKPAK është i ndarë në 4 pjesë:



- Konteksti strategjik.
- Qëllimi i politikave dhe objektivat specifike të strategjisë.
- Zbatimi, përgjegjësia e institucioneve, llogaridhënia, raportimi dhe monitorimi.
- Analiza buxhetore.



Konteksti strategjik flet për **kuadrin ligjor dhe institucional**.

Kuadër ligjor do të thotë grupimi i ligjeve që lidhen me PAK.

Kuadër institucional do të thotë grupimi i institucioneve që lidhen me PAK.



Konteksti strategjik flet edhe për arritjet e kaluara dhe sfidat e hasura.

Në kontekstin strategjik flitet edhe për vizionin dhe misionin e **strategjisë**.

Strategji do të thotë përcaktimi i qëllimeve dhe veprimeve që duhet të ndërmerren në të ardhmen.



Te qëllimi i politikave dhe objektivat specifike të strategjisë janë të renditura të gjitha qëllimet dhe objektivat për t'u arritur.



Janë 8 qëllime të politikave:

- Qëllimi i politikës 1. Realizimi i **aksesueshmërisë** në mjedise, shërbime, transport dhe informacion për PAK.

Aksesueshmëri do të thotë heqja e pengesave të të gjitha llojeve për të marrë shërbime dhe informacion.



- Qëllimi i politikës 2. Garantimi i **aksesit** të barabartë në sistemin e drejtësisë për të gjithë PAK.

Aksesi është mundësia për të marrë informacione dhe shërbime.



- Qëllimi i politikës 3. Rritja e pjesëmarrjes në **tregun e punës** dhe nxitja e mundësive të barabarta për punë të denjë për PAK.

Tregu i punës do të thotë mundësitë që ekzistojnë për t'u punësuar.



- Qëllimi i politikës 4. Sigurimi dhe ofrimi i **arsimit gjithëpërfshirës** dhe cilësor për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara.

Arsim gjithëpërfshirës do të thotë mundësi për edukim për të gjithë fëmijët në të njëjtën klasë.



- Qëllimi i politikës 5. Përmirësimi i **cilësisë së jetës** së PAK nëpërmjet shërbimeve, përfitimeve të aksesueshme, të përballueshme financiarisht dhe që kanë në qendër klientin.

Cilësia e jetës është standardi i shëndetit, rehatisë dhe kënaqësisë që përjeton një individ.



- Qëllimi i politikës 6. Ofrimi i një **kujdesi shëndetësor** të aksesueshëm e të përballueshëm për të gjitha kategoritë e PAK.

Kujdes shëndetësor është përpjekja për të ruajtur trupin dhe mendjen tonë nga sëmundjet.



- Qëllimi i politikës 7. Garantimi i përfshirjes së plotë të PAK në **jetën publike dhe politike** në Shqipëri dhe mundësimi i mbrojtjes së interesave të tyre

Jeta publike dhe politike është përfshirja e plotë në fusha të ndryshme të jetës.



- Qëllimi i politikës 8. Krijimi i **sinergjive** ndërmjet institucioneve dhe fushave të ndryshëm për nxitjen dhe monitorimin e të drejtave të PAK, në mënyrë të plotë, të vazhdueshme dhe të qëndrueshme.

Sinergji do të thotë kombinim dhe organizim i përbashkët.



Te zbatimi, përgjegjësia e institucioneve, llogaridhënia, raportimi dhe monitorimi flitet për:

- Përgjegjësinë e institucioneve.
- Raportimin dhe monitorimin.



Politikat e kujdesit social kanë për qëllim përmirësimin e cilësisë së jetesës së PAK nëpërmjet:

- Balancimit dhe përputhjes së pagesave që përfitojnë për shkak të aftësisë së kufizuar me nevojat dhe përkujdesjen sociale.
- Rritjes së aksesit dhe cilësisë së shërbimeve sociale të ofruara që duhet të



kenë në qendër klientin.

- Kombinimit të pagesave në dorë me shërbime sociale cilësore.




Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale punoi për reformën e shërbimeve shoqërore.

Reforma e re prezantoi edhe modelin e ri të vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

Ky model i vlerësimit quhet modeli biopsikosocial.

Ky model vlerësimi duhet **monitoruar**.


Monitorim do të thotë vëzhgim i thelluar.



Monitorimi do të çojë në analiza të cilat do të na tregojnë efektet që ka patur.

Sipas modelit të ri parashikohet të merren masa për **trajnim** të vazhdueshëm të punonjësve.

Trajnimi është edukim i veçantë për një çështje.



Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale punoi edhe për ngritjen e **shërbimeve** të integruara në **nivel qendror** dhe **lokal**.

Shërbimet në nivel qendror janë shërbime që jepen nga qeveria.

Shërbimet në nivel lokal janë shërbime që jepen nga bashkia.



Sipas Ministrisë, do të kryhet ndërgjegjësimi i njësive vendore për Fondin Social.

Fondi social bën të mundur që çdo bashki të ngrejë shërbime shoqërore për grupet në nevojë.

Fondi social bën të mundur që çdo bashki të mbështesë edhe shërbimet ekzistuese.



Parashikohet edhe të ofrohet shërbimi me interpret të gjuhës së shenjave gjatë **komisionimit**.

Komisionim quhet kur PAK paraqitet për vlerësim në mënyrë që të përfitojë të ardhura ose shërbime.




Sipas reformës së re po bëhet një **ristrukturim** i disa pagesave dhe shërbimeve.

Ristrukturim do të thotë ndryshim i brendshëm.



Ristrukturimi përshin:

- Ristrukturimin e pagesës me para në dorë.
- Ristrukturimin e pagesës së ndihmësit personal.
- Kthimin e pagesave në dorë në pagesa në natyrë (shërbime).



Reforma e shërbimeve shoqërore është aktualisht në zbatim.


Përgjegjësia për të ofruar shërbime është kryesisht e njësive vendore.



Bashkitë duhet të hartojnë **Planin Social**.

Plani Social është një plan i cili paraqet të gjitha nevojat e identifikuara në territorin e bashkisë.

Në planin social bashkitë duhet të shkruajnë edhe nevojat për shërbime për PAK.



Rolin për të monitoruar ofrimin e shërbimeve e kanë **institucionet qendrore**.

Institucione qendrore janë institucionet që janë për të gjithë vendin.



Këto institucione duhet të analizojnë të dhënat e nevojave për shërbime.

Nevojat duhet t'i krahasojnë me vlerësimet e kryera për PAK nga komisionet.



PAK gëzojnë të drejta të barabarta për akses në kujdesin shëndetësor dhe në programe rehabilitimi falas.

Politika e hartuar në këtë dokument ka për qëllim të paturit e shërbimeve shëndetësore të aksesueshme, të përballeshme dhe të barabarta për të gjithë.



Ka një **Strategji të Zhvillimit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor 2020–2025**.

Kjo strategji parashikon edhe përshtatjen e shërbimeve shëndetësore publike.



PKPAK ka parashikuar vendosjen e një pike kontakti për çështjet që lidhen me PAK.

Personi i kontaktit ka për qëllim të monitorojë ofrimin e shërbimeve shëndetësore.



PKPAK ka parashikuar edhe shërbimet dentare për fëmijët me aftësi të kufizuara.



PKPAK është fokusuar edhe në zhvillimin e shërbimeve të parandalimit, ndërhyrjes së hershme dhe rehabilitimit për PAK.

Për këtë parashikohet të hartohen plane individuale të shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara.



Po ashtu, parashikohet edhe diagnostikimi dhe monitorimi nga personeli shëndetësor.



Për personat që nuk dëgjojnë apo kanë vështirësi me dëgjimin do të merren masa konkrete për të identifikuar herët problematikat.



Nevojat për orteza dhe proteza do të evidentohen dhe po ashtu edhe prodhuesit e tyre.



PKPAK synon t'i shtrijë shërbimet e rehabilitimit në të gjithë vendin.

PKPAK parashikon krijimin e një qendre kombëtare rehabilitimi.

Kjo qendër do të shërbejë për të koordinuar shërbimet në territore të caktuara dhe për të trajtuar PAK.



Shërbimi i jetesës së pavarur ka në fokus nxitjen e të jetuarit në komunitet.

Shërbimi i jetesës së pavarur është një kusht për garantimin e përfshirjes sociale të PAK.

Jetesa e pavarur kryesisht ka munguar.



Për të punuar drejt realizimit të këtij shërbimi janë menduar disa masa:

- Miratimi i akteve nënligjore.
- Nxitja e ndërgjegjësimit të qeverisjes vendore.
- Mbështetja e jetesës së pavarur për personat madhorë me aftësi të kufizuara që dalin nga institucionet rezidenciale.
- Ngritja e shtëpive të mbështetura që ofrojnë shërbime për PAK mbi 25 vjeç.
- Nxitja dhe formalizimi i shërbimeve të reja jopublike nga operatorë të specializuar.



Ligjet në Shqipëri garantojnë aksesin në punësim të PAK.

Sipas ligjeve mundësohet punësimi edhe sipas disa programeve të veçanta për nxitjen e punësimit dhe formimit profesional.



Për të rritur punësimin e PAK duhet rritur edhe **aftësimi** i tyre profesional.

Aftësim profesional do të thotë mësimi i aftësive të reja për t'i përdorur në vendin e punës.



Aftësimi profesional arrihet nëpërmjet kurseve profesionale.

Këto kurse ofrohen pa pagesë nga qendrat e formimit profesional.



PKPAK synon të zgjerojë llojet e kurseve profesionale.

PKPAK synon të përshtasë programet e kurseve sipas kategorive të aftësisë së kufizuar.

PKPAK parashikon të trajnojë mësuesit dhe instruktorët për të mësuar PAK.



Është parashikuar edhe **fondi social i punësimit**.

Fondi social i punësimit do të shërbejë për të siguruar nxitjen e punësimit, integrimin dhe përfshirjen sociale të PAK.



Fondi social i punësimit do të bëhet funksional gjatë vitit të parë të PKPAK.



Ky fond do të përdoret për:

- Projekte që synojnë punësimin.
- Vetëpunësimin.
- Rehabilitim për punë.
- Aftësimin dhe riaftësimin profesional.
- Orientimin dhe këshillimin për punësim.



- Shërbime mbështetëse.
- Përshtatjen e vendit të punës për PAK, përfshirë personat që nuk dëgjojnë.
- Programe riintegrimi social dhe mbështetjen për nxitjen e punësimit të familjarëve të PAK.



PKPAK parashikon edhe miratimin e paketës së këshillimit dhe mentorimit të punëdhënësve dhe punëmarrësve.

Punëdhënës quhet ai që ofron punën.

Punëmarrës quhet ai që e përfiton punën.

